



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË MINISTRISË PËR KOMUNITETE DHE KTHIM PËR VITIN  
2022**

**Prishtinë, qershor 2023**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Vlera e prezentuar në PFV e obligimeve të papaguara ishte nënvlerësuar për 72,663€;
- B1 MKK gjatë vitit 2022 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 105,266€ për 20 punonjës (të angazhuar me Marrëveshjen e Brukselit) për të cilët nuk ka dëshmi për vijueshmëri në punë;
- C1 Vlera e pasurisë kapitale e prezentuar në PFV ishte mbivlerësuar për 799,966€ si rezultat i mos bartjes së pasurisë në komunat përkatëse dhe kategorizimit të gabuar të pasurive në anën tjetër kemi nënvlerësim të pasurisë jo kapitale në PFV për 74,968€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e

përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë për Komunitete dhe Kthim kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## **Baza për konkluzion**

A2 MKK në një rast kishte përzgjedhur operatorin ekonomik i cili nuk i kishte plotësuar në tërësi kriteret e përshtatshmërisë sipas dosjes së tenderit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri për Komunitete dhe Kthim është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat në të cilat janë identifikuar mangësi dhe që kërkojnë veprime të menjëhershme për shkak të ndikimit të tyre në PFV janë menaxhimi dhe mirëmbajtja e regjistrave të pasurive, shpalosja e obligimeve të papaguara si dhe pagesa e zyrtarëve të komunitetit serb në mungesë të evidencave për ardhje-vajtje në punë. Po ashtu, veprime duhet të ndërmerren edhe tek çështjet tjera të identikuara në kategoritë përkatëse si mangësi në procedurat e prokurimit, monitorimin e investimeve kapitale, klasifikimi joadekuat i shpenzimeve, ekzekutimi i pagesave si dhe shfrytëzimi i veturave zyrtare.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, pesë (5) prej tyre janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim pjesërisht i zbatuar dhe dy (2) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja A1 - Nënvlërësim i obligimeve në PFV

**Gjetja** Sipas nenit 17 pika 1 të Rregullores MF – Nr.01/ 2017 për Raportim vjetor financiar të organizatave buxhetore përcakton që ‘Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Më tej pika 3 – ‘Organizatave buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues’.

Gjatë testimit identifikua se fatura në vlerë prej 489,899€ e pranuar me 27.05.2022 ishte paguar pjesërisht në vlerë prej 417,236€ në ditën e njëjtë të pranimit.

Obligimi i mbetur prej 72,663€ nuk ishte raportuar në raportet mujore të obligimeve dhe nuk ishte shpalosur në PFV si obligim i papaguar i vitit 2022.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në evidentimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara.

**Ndikimi** Kontrolllet e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve kanë ndikuar në shpalosje jo të drejtë të obligimeve në PFV.

**Rekomandimi A1** Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se raportimi mujor i faturave të papaguara paraqet gjendjen e saktë të tyre me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B1 - Kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri të plotë në punë

**Gjetja** Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik”.

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur “Mbrojtja Civile”.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje për integrim, në MKK përmes akt-emërimeve janë të punësuar 20 pjesëtarë të ashtuquajturës “Mbrojtja civile” të cilët marrin paga të rregullta mujore.

Shpenzimet për pagat e tyre për vitin 2022 ishin në vlerë prej 105,266€. MKK kishte filluar të punësuarit t'i angazhoj në monitorim të projekteve kapitale për disa ditë gjatë vitit. Të angazhuar ishin vetëm gjashtë zyrtarë



me detyra të monitorimit prej 1-3 ditë gjatë gjithë vitit.

Kjo dukuri vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerr masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e plotë të kësaj kategorie të të punësuarve.

**Ndikimi** Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

**Rekomandimi B1** Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

## **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### **Çështja C1 - Prezantim jo i saktë i pasurisë në PFV**

**Gjetja** Neni 13 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Më tej, sipas nenit 6.1 'Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Për më tepër, neni 22 i kësaj rregullore përcakton metodën e zhvlerësimit të pasurive, normën si dhe llogaritjen bazuar në natyrën e pasurisë.

Vlera e prezantuar e pasurisë kapitale dhe jo kapitale në PFV ishte mbivlerësuar për 799,966€, në anën tjetër ishte nënvlerësuar për 74,968€ si rezultat i çështjeve të identifikuara, si në vijim:

- MKK vazhdon ti mbajë në regjistrat e saj si pasuri në vijim projektet e përfunduara për të cilat ishte bërë pranimi teknik nga komisionet përkatëse. Këto projekte i takojnë komunave përkatëse dhe ishin në vlerë prej 702,867€ (pajisje mjekësore dhe ndërtimi i shtëpive), duke e mbivlerësuar vlerën e pasurive kapitale për të njëjtën shumë.

Vlen të theksohet se bazuar në rekomandimin nga ZKA, MKK në bashkëpunim me Thesarin gjatë vitit 2022, kishte larguar nga regjistrat e saj pasuri në vijim për të cilat ishin raportet e pranimit teknik e të cilat nuk i takojnë ministrisë. Vlera e këtyre pasurive të transferuara ishte 21,415,168€.

- Pagesa në vlerë 78,213€ për realizimin e projektit "Mbështetje e një zgjedhje të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë" kishte të bënte me pagesë të qirasë dhe mbështetje teknike. E njëjta ishte regjistruar si pasuri në SIMFK, duke mbivlerësuar regjistrin e pasurisë për këtë vlerë.
- Në 11 raste të testuara <sup>5</sup> vlera e prezantuar e pasurisë në PFV ishte

mbivlerësuar për 18,886€ si rezultat i kategorizimit jo të drejtë të klasave të pasurisë si dhe mos aplikim i zhvlerësimit në sistemi e-pasuria.

Vlera e pasurisë jo kapitale nën 1,000€ e shpalosur në PFV ishte nënvlerësuar për 74,968€. Kjo pasi që, ministria kishte shpalosur vetëm blerjet gjatë vitit 2022 në vlerën prej 4,845€. Ndërsa sipas softuerit të e-pasurisë kjo kategori arrinte vlerën prej 79,813.

Mbivlerësimi i regjistrave të pasurisë dhe mangësitë e identifikuara kanë ardhur si rezultat i pakujdesisë dhe funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në këtë fushë.

#### **Ndikimi**

Mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunat përfituese, mos aplikimi i zhvlerësimit si dhe regjistrimi i pasurisë e cila nuk i plotëson kriteret për kapitalizim ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe mbivlerësim të vlerës së pasurisë në PFV.

#### **Rekomandimi C1**

Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e plotë të pronësisë së pasurisë tek komunat dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrit të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë, po ashtu të largoj nga regjistrat e pasurisë shpenzimet operative në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt dhe saktë në PFV e vitit 2023. Për më tepër, të siguroj se aplikohet një analizë e mirëfilltë e regjistrit të pasurive, në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Mangësi në vlerësim të ofertës së prokurimit

#### Gjetja

Neni 59 pika 4 e Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik, specifikon që: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në procedurën e prokurimit për kontratën “Transporti i punëtorëve të MKK-së” në vlerë prej 14,268€, identifikua se nuk ishin plotësuar kriteret e vendosura në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit ishte kërkuar që “OE duhet të ketë automjet për transport të punëtorëve – minimumi 20 ulëse”, automjeti i cili do të përdoret për transport duhet të jetë jo më i vjetër se viti 2012 dhe të dëshmohet me librezë në emër të OE.

Automjeti me të cilin kishte ofertuar OE fitues i kontratës posedonte 18 ulëse dhe nuk ishte në pronësi të OE por i njëjti kishte marrëveshje për shfrytëzimin e tij.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos evidentimit të shmangieve me kërkesat e tenderit nga ana e Komisionit Vlerësues.

#### Ndikimi

Mos respektimi i kriterëve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave ndikon me shpërblim me kontratë të OE të pa përgjegjshëm. Po ashtu, rritë rrezikun që realizimi i kontratave të mos arrij qëllimin e synuar.

#### Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që komisioni i vlerësimit kryen vlerësimin në pajtueshmëri të plotë me kërkesat që rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte në vlerë prej 273,517€, prej tyre ishin shpenzuar 201,869€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për pajisje të TI-së, shërbime kontraktuese, furnizim me material për zyre etj.

#### Çështja A3 - Shfrytëzimi i veturave zyrtare në kundërshtim me Vendimin e Qeverisë

**Gjetja** Vendimi NR.02/30 i dt.12.05.2020 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kufizon përdorimin e automjeteve zyrtare vetëm gjatë orarit të rregullt të punës me qëllim të racionalizimit të shpenzimit të parasë publike. Ky vendim shfuqizon të gjitha aktet paraprake lidhur me këtë qëllim.

Ne kemi identifikuar që zyrtarët e MKK-së përdorin automjetet zyrtare edhe pas orarit të rregullt të punës. Numri i automjeteve që janë përdorur gjatë vitit nga të punësuarit e ministrisë jashtë orarit të punës është 17.

Për më tepër, nuk janë mbajtur evidenca të përdorimit të automjeteve gjatë orarit të rregullt të punës, fletëudhëtimet nuk kishin informata të sakta dhe kishte mos përputhje në mes të destinimeve të evidentuara me kilometrat e shpenzuara.

Vlen të theksohet që ministria kishte të kontraktuar një autobus për bartjen e të punësuarve nga vendi i punës.

Përdorimi i automjeteve zyrtare jashtë orarit të rregullt të punës si dhe mos plotësimi i fletëudhëtimeve është pasojë e mos zbatimit të kontroleve nga ana e menaxhmentit.

**Ndikimi** Përdorimi i automjeteve nga zyrtarët jashtë orarit të rregullt të punës rrit shpenzimin e parasë publike duke ngarkuar buxhetin e ministrisë. Po ashtu, mos plotësimi i fletëudhëtimeve me informata të sakta lë hapësirë për keqpërdorim të mundshëm të veturave zyrtare.

**Rekomandimi A3** Ministri duhet të siguroj se shfrytëzimi i automjeteve zyrtare të ministrisë bazohet në vendimin e Qeverisë. Për rastet specifike Ministri duhet të adresoj kërkesën e arsyeshme për aprovim tek Qeveria për shfrytëzimin e veturave jashtë orarit të rregullt të punës. Po ashtu, të ketë informata të plota sa i përket përdorimit të tyre për qëllime zyrtare

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në vitin 2022 ishte 300,000€, prej tyre ishin shpenzuar 62,924€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e projekteve për stabilizimin, forcimin ekonomik dhe integrimin e komuniteteve nga lëmia e zhvillimit ekonomik, arsim, hulumtime, trajnime, lëmia e mediave, sport, kulturë.

### Çështja A4 - Mangësi në monitorimin e subvencioneve

**Gjetja** Neni 4 pika 2 e Memorandumit të mirëkuptimit në mes të MKK dhe përfituesve të subvencioneve, përcakton që: Përfituesit janë të detyruar që t'i përmbahen në tërësi planeve të realizimit të projekteve sipas kërkesës. Më tej, paragrafi 3, thekson që 30 ditë pas realizimit të projektit përfituesi është i detyruar që të dorëzojë raportin përfundimtar narativ, raportin financiar si dhe të ofrojë dëshmi (fatura të rregullta, kupon fiskal ose transaksion bankar) që dëshmojnë se subvencioni është realizuar sipas planit dhe në pajtim me memorandumimin.

Nga testimi kemi identifikuar që në pesë (5) raste<sup>6</sup> përfituesit e subvencioneve nuk kishin implementuar/realizuar projektet sipas planit për realizim si dhe faturat e dorëzuara nuk përkojnë me kohën e implementimit të projekteve. Vonesat ishin deri në 4 muaj përtej afatit të përcaktuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së përvojës të zyrtarëve përgjegjës lidhur me monitorimin e implementimit të subvencioneve/projekteve.

**Ndikimi** Vonesat e llogaridhënies nga të subvencionuar për shpenzimet e ndodhura nuk ofron siguri se qëllimet e projekteve janë arritur rrjedhimisht edhe objektivat e ministrisë.

**Rekomandimi A4** Ministri duhet të sigurojë se zyrtarët për monitorim të projekteve të financuara nga subvencionet dhe transferet kanë njohuri të mjaftueshme për monitorimin e tyre duke siguruar raportim financiar dhe narativ për shpenzimet e ndodhura nga përfituesit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,937,251€, prej tyre ishin shpenzuar 1,902,325€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin e infrastrukturës, kanalizimit dhe ujësjellësit si dhe ndërtesave të banimit për komunitetet jo shumicë, ndërtimin e sallave sportive, objekteve shëndetësore, furnizimin me laborator dhe aparaturë mjekësore si dhe transferet për organizatat ndërkombëtare për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për personat e kthyer.

#### Çështja A5 - Vonesat në realizimin e punimeve

##### Gjetja

Bazuar në Memorandumet e Mirëkuptimit ndërmjet MKK-së dhe komunave përkatëse përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e palëve lidhur me implementimin e marrëveshjes. Në kontratat e nënshkruara ndër tjerash përcaktohet edhe afati kohor për realizimin e punimeve.

Ne kemi identifikuar dy (2) raste ku punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik, siç parashihej me kontratë:

- Afati për përfundimin e punimeve për projektin 'Ndërtimi i sallës sportive' në fshatin Biti e lartë - Komuna e Shtërpcës, në vlerë prej 184,998€ ishte 180 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës me dt. 27.04.2022. Kjo kontratë ishte bazuar në Marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të MKK-së dhe Komunës së Shtërpcës. Deri në fund të 2022 ishin pranuar tri situacione në vlerë totale prej 155,318€. Bazuar në Planin për menaxhimin e projektit nga menaxheri i kontratës afati i përmbushjes së planit duhet të jetë dt.15.12.2022. Gjatë ekzaminimit fizik me dt.27.04.2023 kemi evidentuar që salla sportive ende nuk ishte përfunduar dhe se veq kishin filluar dëmtimet në tavanin e kësaj ndërtese.
- Afati për përfundimin e punimeve për projektin 'Ndërtimi i sallës pranë kishës Sveti Nikolla' në fshatin Banjskë - Komuna e Vushtrisë, në vlerë prej 51,058€ ishte 50 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës me dt.23.11.2021. Sipas planit për menaxhimin e kontratës punimet do të fillonin nga 30.11.2021 deri më 10.01.2022. Për këtë projekt MKK ka realizuar procedurat e prokurimit dhe menaxhimit të projektit. Arsyeja e vonesës ishte për shkak të kushteve të këqija atmosferike (periudha dimërore), në pritje të formimit të strukturave komunale pas zgjedhjeve dhe pritjes së përcaktimit të lokacionit për ndërtim nga shërbimi komunal i gjeodezisë. Nisja e punimeve është bërë me lëshimin e kushteve teknike nga autoritetet komunale. Aktualisht (prill 2023) projekti është në fazën e pranimit teknik.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit jo të duhur projekteve si dhe monitorimit jo të mjaftueshëm nga ana e menaxherëve të kontratave.

##### Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MKK të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

##### Rekomandimi A5

Ministri duhet të sigurojë se bëhet një planifikim më real i projekteve duke marrë për bazë ndër tjerash edhe rrethanat që mund të ndikojnë në realizimin e tyre. Po ashtu, përmes menaxherëve përkatës të sigurojë mbikëqyrje të duhur gjatë realizimit të tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale**

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,969,191 €, pasurive jokapitale është 4,845 €, si dhe e stoqeve 20,255€. MKK gjatë vitit 2022 në bashkëpunim me Thesarin, kishte larguar nga regjistri i saj pasuritë në vijim për të cilat ishin raportet e pranimit teknik. Vlera e këtyre pasurive ishte 21 mln të cilat janë transferuar tek komunat përkatëse/përfituese. Kjo kishte reflektuar edhe në uljen e vlerës së pasurisë kapitale.

**Çështja B2 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe mosharmonizimi i regjistrave**

**Gjetja** Sipas nenit 18.1 të Rregullores – Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, "Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare". Neni 17.2 përcakton që " Zyrta i Pranimit/Logjistikës nuk do të ketë të drejtën të jetë një prej anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare dhe Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare; si dhe të vendos në çështjet që janë të ndërlidhura me tjetërsimin e pasurive.

MKK kishte caktuar komisionin për inventarizim të pasurisë, anëtar i të cilit ishte përzgjedhur zyrtari i Pranimit/Logjistikës. Më tej, ky komision kishte përpiluar një raport i cili nuk përfshinte të gjithë pasurinë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të ministrisë, por përmbante informata vetëm për pasurinë nën 1,000€ të cilat ndodheshin fizikisht nëpër zyrat e MKK-së. Komisioni i inventarizimit nuk kishte bërë ndonjë krahasim të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive të komisionit të inventarizimit si dhe mungesës së rishikimit nga ana e menaxhmentit të gabimeve eventuale.

**Ndikimi** Harmonizimi i regjistrat të pasurive me inventarizim do të ndikonte direkt në identifikimin e pasurive të cilat nuk janë në pronësi të MKK-se dhe pasurive që duhet të largohen nga regjistrat duke mundësuar azhurnimin e regjistrat me informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

**Rekomandimi B2** Ministri duhet të sigurojë se pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV e vitit 2023 të jetë i saktë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>7</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>4,382,895</b>	<b>3,320,148</b>	<b>2,871,886</b>	<b>4,101,464</b>	<b>4,090,935</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	4,382,895	3,320,148	2,871,886	4,101,464	4,090,935
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	0

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,062,747€ apo rreth 24% ose 4,382,895€. Ky ndryshim është rezultat i zvogëlimit të buxhetit tek IK me vendim të Qeverisë.

Në vitin 2022 MKK kishte shpenzuar 2,871,886€ apo rreth 86% të buxhetit final, me një performancë më të mirë në krahasim me vitin 2021 ku realizimi i buxhetit ishte në nivel 81%.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>4,382,895</b>	<b>3,320,148</b>	<b>2,871,886</b>	<b>4,101,464</b>	<b>4,090,935</b>
Pagat dhe mëditjet	792,378	792,378	700,827	726,367	739,819
Mallrat dhe shërbimet	273,517	273,517	201,869	230,858	203,197
Komunalitë	17,000	17,000	3,940	4,160	4,759
Subvencionet dhe transferet	300,000	300,000	62,924	73,329	288,399
Investimet Kapitale	3,000,000	1,937,253	1,902,326	3,066,749	2,854,760


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar tek kategoria e pagave dhe mëditjeve nuk kishte ndryshime, buxhet ishte shpenzuar në nivel rreth 88%. Ky realizim ishte i ndikuar nga pamundësia e mbulimit të pozitive të lira. Edhe përkundër që sipas Ligjit të buxhetit për 2022 janë paraparë 121 pozita, në fund të vitit ministria kishte të punësuar 103, si dhe dorëheqjet e stafit, pensionimet dhe pushimet pa pagesë të personelit të ministrisë;



- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte realizuar rreth 74% ndërkohë që nuk kishte lëvizje buxhetore gjatë vitit për këtë kategori;
- Buxheti final për shpenzime komunale deri në fund të vitit ishte realizuar rreth 23%. Shpenzimi i ulët në këtë kategori ishte si rezultat i pagesës së shpenzimeve komunale nga ana e MAPL-së<
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin kishte mbetur i pandryshuar. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte rreth 21%. Shpenzimi i ulët në këtë kategori është si rezultat i numrit të ulët të kërkesave për subvencionim gjatë vitit raportues;
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,062,747€ me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 98%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat sipas projeksioneve buxhetore të MF ishin në vlerë prej 1,409€. MKK nuk ka të hyra të rregullta dhe rrjedhimisht nuk kishte arkëtuar të hyra gjatë vitit 2022.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,409</b>	<b>1,409</b>		<b>2,778</b>	<b>1,819</b>
Të hyrat jo tatimore	1,409	1,409			
Të hyrat tjera	0	0		2,778	1,819

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të MKK ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime. MKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, MKK ka dorëzuar raportin për progresin në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, katër (4) rekomandime janë zbatuar, dy (2) nuk janë zbatuar si dhe një (1) ishte zbatuar pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Edhe gjatë vitit aktual është e njëjta gjendje.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë tek përfituesit dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrit të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt në PFV.	MKK kishte ndërmarrë hapa drejt bartjes së pronësisë tek komunat përkatëse, ku kishte bartur pasurine në vlerë prej 21 mln €. Megjithatë në kemi evidentuar raste të reja të	Pjesërisht i zbatuar

			mos bartjes së pasurisë gjatë vitit 2022.	
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Ne nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2022.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri përmes personave përgjegjës duhet të mbikqyrë në mënyrë më rigorozë realizimin e marrëveshjes. Po ashtu duhet të sigurojë se me fondet e ministrisë përmbushet plotësisht objektiva për ndërtimin e shtëpive sipas afateve të përcaktuara.	Gjatë vitit aktual MKK në bashkëpunim me IOM kishte arritur përmbushjen e planit për ndërtimin e shtëpive.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri, duhet të sigurojë që komisioni i vlerësimit bënë ekzaminimin e plotë të ofertave, dhe aty ku paraqitet nevoja për sqarime shpesh nga OE, të kërkojë informata sqaruese.	Ne nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2022.	I zbatuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Ministri, duhet të sigurojë që pagesat për përfituesit të bëhen në përputhje me kriteret, në mënyrë që të arrijë të bëjë monitorimin e shpenzimeve dhe realizimin e projekteve, me qëllim që me këto subvencione të përmbushen objektivat e synuara të ministrisë.	Ne nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2022.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV të jetë i saktë.	Edhe gjatë vitit 2022 nuk kishin arritur të konsolidojnë dhe të harmonizojnë Regjistrin e pasurive dhe inventarizimin.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit




Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of  
Communities and Return

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për  
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Nenad Rasic

Ministër i Ministrisë për Komunitet dhe Kthim,

Data: 23.qershor.2023

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>9</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>9</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Furnizim me pajisje laboratorike dhe aparatura mjekësore në vlerë prej 688 699.0€; Komuna Mitrovicë e Veriut, 2. Ndërtimi i shtëpive në vlerë 4,175€; 3. Pajisja e Konakut me inventar në Ropotovë të Madhe, Komuna Ranillug, në vlerë 9 992,00 €, dhe Zhvlerësimi: 1. Smart phone 586.97€; 2. TV 49" Smart TV 187.52€; 3. Televizor TV 337.70€; 4. Tablet 516.53€; 5. Tablet 377.14€; 6. SmartphoneHandheldGimbalStabilizer390€; 7. SmartphonehandheldGimbalStabilizer 390€; 8. Krijimi i bazës qendrore së të dhënave për regjistrimin e personave të zhvendosur dhe të kthyerve 14,850€; 9. Smart phone 586.97€; 10. Televizor 273.33€; 11. SmartphonehandheldGimbalStabilizer 390€.
- <sup>6</sup> 1. Projekti: Zupsko Podgorski Susreti 2022; 2. Ndihmë për organizimin e Kurban Bajramit në Gorë; 3. Ndihmë për shërim- Mitrovicë; 4. Përkrahje për organizimin e ditës ndërkombëtare të Romëve- Gracanicë; 5. Organizimi i manifestimit tradicional.
- <sup>7</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>8</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>9</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.